



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITETI  
"HAXHI ZEKA"

## SYLLABUS i Lëndës

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Menaxhmentit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis
<b>Titulli i lëndës:</b>	Gjuhë Angleze I
<b>Niveli:</b>	Bachelor
<b>Statusi lëndës:</b>	Obligative
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti II / Semestri III
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+2
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	5
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>FAKULTETI MTHM</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Prof.Asoc. Lirak Karjagdiu
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<a href="mailto:lirak.karjagdiu@uni-pr.edu">lirak.karjagdiu@uni-pr.edu</a>
<b>Celulari:</b>	
<b>Asistenti i lëndës:</b>	MSc.Libron Kelmendi
<b>Detajet kontaktuese:</b>	libronkelmendi@hotmail.com
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	Gjuha angleze I synon të zhvillojë aftësitë e studentëve në aftësitë receptive (të dëgjuarit dhe të lexuarit) dhe aftësitë produktive (të folurit dhe të shkruarit). Edhe pse qëllimi kryesor i kësaj lënde do të jetë zhvillimi i aftësive komunikuese, lënda i njofton studentët me konceptet bazë të gramatikës angleze. Lënda fokusohet gjithashtu në përmirësimin e rrjedhshmërisë së studentëve, një fjalor më të madh dhe aftësinë për të shprehur veten duke përdorur struktura të thjeshta gramatikore.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi i kësaj lënde është që: <ul style="list-style-type: none"><li>• t'u mundësojë studentëve të zhvillojnë aftësitë bazë të gjuhës angleze;</li><li>• të zgjerojë njohuritë e studentëve për gramatikën bazë të anglishtes;</li><li>• t'i njohë studentët me terminologjinë dhe frazeologjinë e përdorur në fushën e menaxhimit të turizmit, hotelierisë dhe mjedisit;</li><li>• të rrisë besimin dhe aftësinë e studentëve për të komunikuar në anglisht si në të folur ashtu edhe në të shkruar;</li><li>• të zhvillojë aftësitë studimore të studentëve.</li></ul>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje të:

	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përdorin terminologjinë bazë të gramatikës angleze;</li> <li>2. Kuptojnë një larmi formash dhe mënyrash komunikimi, përshëndetjet, bisedat e shpeshta, shprehjet e ndryshme të sjelljeve, njerëzve dhe situatave të përditshme;</li> <li>3. Kuptoj mesazhe të thjeshta, informacione personale, histori të zakonshme për tema që lidhen me turizmin, mikpritjen, familjen, shënimet, blerjet, udhëzimet për vende të ndryshme, profesionin, moshën, vendin e lindjes, shkollën, arsimin dhe aspektet tërheqëse të gjuhës angleze;</li> <li>4. Të lexojnë, diskutojnë dhe shkruajnë tekste dhe kumtesa, të cilat përmbajnë terminologji nga fushat dhe lëndët që mësojnë.</li> </ol>
--	---

--

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimsdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren			
Kollokfiime, seminare	1	3	3
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1	2
Projektet, prezantimet ,etj			
<b>Totali</b>			<b>125/25=5 ECTS</b>

--

<b>Metodologjia e mësimsdhënies:</b>	Metodologjia e mësimsdhënies së kësaj lënde do të jetë interaktive, me në qendër studentin. Një qasje mësims-praktikë-përdorim do të ju mundësoje studentëve që të bëhen funksionalë në gjuhën angleze. Qëllimet e lëndës do të arrihen përmes diskutimit të temave, përmes prezantimeve të studentëve, detyrave, punës në çifte dhe grupe që do të rezultojë në pasurimin e fjalorit të hotelerisë dhe turizmit, fjalor i nevojshëm për nevojat e studentëve. Prandaj, pjesëmarrja aktive e studentëve do të jetë thelbësore për përmbushjen e qëllimeve lëndore, si dhe për arritjen e rezultateve të të nxënit.
--------------------------------------	--

--

<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Punimi seminarik	Deri në 10 pikë dhe këto pikë vlerësohen në totalin e pikëve nga kollokviumi dhe provimi përfundimtar.
	Kollokviumi	50% e pikëve të mundshme + 1 pikë kërkohen për ta konsideruar të

		sukseshëm kollokviumin dhe pikët e arritura i shtohen pikëve të arritura nga provimi përfundimtar.
	<b>Provimi përfundimtar</b>	<b>Për ta konsideruar provimin të sukseshëm kërkohen 50% të pikëve të mundshme +1 pikë. Në vlerësimin përfundimtar shtohen pikët nga punimi seminarik dhe kollokviumi.</b>
	<b>Nota përfundimtare</b>	<b>51-60% - 6 61-70% - 7 71-80% - 8 81-90% - 9 91-100% -10</b>

<b>Literatura bazë:</b>	Swan, M., & Walter, C. (2001). The Good grammar book: A grammar practice book for elementary to lower-intermediate students of English. Oxford: Oxford University Press.
<b>Literatura shitesë:</b>	Walker, R., Harding, K., & Oxford University Press. (2015). Oxford English for careers: Tourism 3 : student's book. Oxford: Oxford University Press. Kalnins, S., & Zayat, J. (2014). Communicating with grammar: Skills for life. Berry, R. (2018). English grammar. Murphy, R. (2009). Essential grammar in use: A self-study reference and practice book for elementary students of English. Cambridge: Cambridge University Press.

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Hyrje në lëndën, tekstin mësimor, planprogramin, ligjëratat dhe ushtrimet, detyrat, kollokviumin, provimin përfundimtar.
<b>Java e dytë:</b>	Folja; Kategoritë gramatikore të foljes.
<b>Java e tretë:</b>	Foljet e rregullta dhe të parregullta. Foljet ndihmëse. Foljet modale. Foljet veprorë dhe joveprorë. Foljet kalimtare dhe jokolimtare.
<b>Java e katërt:</b>	Frazat foljore; Kohët e foljeve.
<b>Java e pestë:</b>	Present Simple dhe Present Continuous
<b>Java e gjashtë:</b>	Present Perfect dhe Present Perfect Continuous
<b>Java e shtatë:</b>	Past Simple dhe Past Continuous
<b>Java e tetë:</b>	Past Perfect dhe Past Perfect Continuous
<b>Java e nëntë:</b>	Simple Present për ngjarjet e së ardhmes; Present Continuous për ngjarjet e së ardhmes; Koha e ardhme e shprehur me GOING TO.
<b>Java e dhjetë:</b>	Future Simple dhe Future Continuous
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Future Perfect dhe Future Perfect Continuous
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Llojet e fjalive pyetëse: Pyetjet Po/Jo (Yes/No questions); pyetjet mohuese; pyetjet informuese; Tag questions
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Frazat; Fjalët, Morfemat; Proceset e fjalëformimit.
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Klasifikimi i fjalive.
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Rekapitullim i lëndës

<b>Java</b>	<b>Ushtrimi që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Hyrje në lëndën, tekstin shkollor, aktivitetet praktike dhe metodologjinë.
<b>Java e dytë:</b>	Foljet leksikore dhe ndihmëse. Foljet modale.
<b>Java e tretë:</b>	Foljet e rregullta dhe të parregullta. Formimi dhe përdorimi.
<b>Java e katërt:</b>	Kohët e foljes. Përdorimi në mënyre korrekte.
<b>Java e pestë:</b>	Formimi dhe përdorimi i Present Simple dhe Present Continuous. Aktivitete në të shkruar dhe në të lexuar. Rikrijimi i pjesëve të teksteve. Ushtrime të ndërlidhura me njësinë mësimore.
<b>Java e gjashtë:</b>	Formimi dhe përdorimi i Present Perfect dhe Present Perfect Continuous. Aktivitete në të shkruar dhe në të lexuar. Analizë e pjesëve të teksteve. Ushtrime të ndërlidhura me njësinë mësimore.
<b>Java e shtatë:</b>	Formimi dhe përdorimi i Past Simple dhe Past Continuous. Aktivitete në të shkruar dhe në të lexuar. Ushtrime të ndërlidhura me njësinë mësimore.
<b>Java e tetë:</b>	Formimi dhe përdorimi i Past Perfect dhe Past Perfect Continuous. Aktivitete në të shkruar dhe në të lexuar. Rikrijimi i fjalive. Ushtrime të ndërlidhura me njësinë mësimore.
<b>Java e nëntë:</b>	Hyrje në kohët e ardhshme të foljes.
<b>Java e dhjetë:</b>	Formimi dhe përdorimi i Future Simple dhe Future Continuous. Aktivitete në të shkruar dhe në të lexuar. Ushtrime të ndërlidhura me njësinë mësimore.
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Formimi dhe përdorimi i Future Perfect dhe Future Perfect Continuous. Aktivitete në të shkruar dhe në të lexuar. Ushtrime të ndërlidhura me njësinë mësimore.
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Identifikimi i llojit të pyetjes. Rishkrimi i fjalive pyetëse.
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Pasurimi i fjalorit. Të shkruarit e fjalëve dhe frazave. Elaborimi i proceseve të fjalëformimit.
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Struktura e fjalive.
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Rekapitullimi i temave.

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studenti është i detyruar të respektojë institucionin duke zbatuar të gjitha rregullat e përcaktuara të arsimit; Studenti është i detyruar të marrë pjesë aktive në ligjërata dhe ushtrime; Studenti nuk duhet të hyjë në klasë nëse janë vonë ose planifikojnë të largohen më herët nga mësimi; Gjatë diskutimeve në klasë ata duhet të respektojnë njëri-tjetrin, të jenë tolerantë ndaj mendimeve të kundërta, të parandalojnë gjykimin dhe ofendimin, të shprehin lirshëm mendimet e tyre, por të jenë të kujdesshëm dhe tolerantë ndaj mendimeve të nxënësve të tjerë.